

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXII, nr. 6593  
E enjte, 28 prill 2022  
çmimi 0.40 €

## Komunat kërkojnë transparencë nga qeveria dhe koordinim të plotë

FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR ABBRUCH GMBH**  
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", FERAT SHALA | FAQE 4-5

# QEVERIA KURTI, PA STRATEGJI ZHVILLIMORE



Deputeti i PDK-së, Ferat Shala, e ka akuzuar qeverinë Kurti për mosrealizimin e premtimëve. Shala ka thënë se kjo qeveri nuk ka asnjë strategji për zhvillimin e vendit. Në këtë intervistë dhënë për "Epokën e re", Shala ka thënë se PDK-ja ka pasur dhe ka indikacione se qeveria Kurti ka qenë dhe është thëllë e zhytur në afera të dyshimta në tërë sektorin energjetik. "Qeveria ka qenë thëllë e zhytur në keqmenaxhimin e krizës energjetike, me ndërhyrje politike në gjithë sektorin energjetik, me ndërhyrje në ZRRë, me ndërhyrje të mëdha financiare, pa qartësi dhe transparencë, pa bazë ligjore dhe pa arsye ekonomike", ka thënë Shala. Në këtë kontekst, Shala ka thënë se është e domosdoshme që të themelohet Komisioni Hetimor për Energji. Ndërsa sa i përket opozitës, Shala ka thënë se nuk ka kopjuar asgjë nga metodat opozitare nga e kaluara

Shkruan:  
Kudusi LAMA



## FEJTON

### PARIMET QË KANË UDHËHEQUR SERBËT NË PROCESIN E PUSHTIMIT DHE TË TJETËRSIMIT TË TROJEVE SHQIPTARE F. 3

## AKTUALE



### BLINKENI THOTË SE PUTINI NUK ËSHTË SERIOZ QË T'I JAPË FUND LUFTËS PËRMES DIPLOMACISË F. 2

### ZVICRA DHURON PAJISJE BIOMETRIKE PËR POLICINË KUFITARE F. 6

## EKONOMI



### PDK-ja: TË ZBARDHET E VËRTETA E SHITBLERJES SË RRYMËS F. 8

### 26 MIJË FAMILJE NË SKEMËN SOCIALE MARRIN DYFISHIN E VLERËS F. 8

## SPORT

### PRISHTINA FITON DERBIN NDAJ GJILANIT F. 10

### Skandali i ambasadorit Berishaj, PSD-ja aksion për 'pastrimin e parave' para qeverisë

FAQE 3



## KOSOVA PËRKUJTON TË PAGJETURIT DHE MASAKRËN E MEJËS

FAQE 8

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Curëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNIAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 870 | 045 500 870  
044 500 870 | 049 500 870

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Blinkeni thotë se Putini nuk është serioz që t'i japë fund luftës përmes diplomacisë

WASHINGTON, 27 PRILL - Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, ka deklaruar se presidenti rus Vladimir Putin nuk ka treguar seriozitet që lufta në Ukrainë të përfundojë përmes diplomacisë, pavarësisht disa përpjekjeve ndërkombëtare. "Deri më tani nuk kemi parë asnjë shenjë se presidenti Putin është serioz për negociatën kuptimplote", ka thënë Blinken para Komitetit për Punë të Jashtme të Senatit amerikan. Përderisa ShBA-ja do t'i mbështesë përpjekjet ukrainase për t'i dhënë fund luftës përmes

diplomacisë, Blinken tha se "qëllimi ynë është që të sigurohemi se ata kanë në duart e tyre aftësinë që t'i kundërvihen agresionit rus dhe ta forcojnë pozicionin e tyre në tavolinën e negociatave". Blinken iu përgjigj kështu pyetjeve të senatorit republikan, Rand Paul, i cili e akuzoi presidentin amerikan, Joe Biden, se ka kontribuar në vendimin e Putinit për ta pushtuar Kievin pasi, sipas tij, ai ka folur për mundësinë që Ukraina të pranohet në NATO. Por, Blinken tha se në bisedimet me Rusinë, para nisjes së



pushtimit më 24 shkurt, ishte e qartë se shqetësimet e Putinit lidhur me bashkimin e Ukrainës

në këtë aleancë perëndimore ishin pretekst për nisjen e luftës. "Ne tentuam që të

angazhoheshim me ta në këto situata me seriozitet. Është shumë e qartë dhe, sipas fjalëve të vet presidentit Putin, kjo luftë kurrë nuk ishte për faktin se Ukraina potencialisht mund të bëhej pjesë e NATO-s, por ka të bëjë me besimin e tij se Ukraina nuk e meriton të jetë një vend sovran dhe i pavarur", ka thënë ai. Rusia ka nisur pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt. Në javët e fundit, trupat ruse janë tërhequr nga veriu i Ukrainës dhe kanë thënë se do t'i përqendrojnë operacionet e tyre ushtarake për ta "çliruar" lindjen e Ukrainës.

## Rusia sanksionon 287 ligjvënës britanikë



MOSKË, 27 PRILL - Moska ua ka ndaluar hyrjen në Rusi 287 anëtarëve të parlamentit britanik dhe i ka akuzuar ata se po nxisin në Britani "histeri rusofobike". Për shkak të pushtimit rus të Ukrainës, Britania dhe aleatët e tjerë kanë vendosur sanksione të ashpra ndaj oligarkëve dhe elitave politike ruse, përfshirë edhe ndaj presidentit rus Vladimir Putin. Ministria e Jashtme ruse tha se sanksionimi i ligjvënësve

britanikë ishte në kundërpërgjigje të masave të ngjashme të vendosura nga Britania ndaj 386 anëtarëve të Dhomës së Ulët të Parlamentit rus më 11 mars. "Këta persona kanë marrë pjesë në mënyrë aktive për të krijuar instrumente sanksionesh ndaj Rusisë dhe kanë kontribuar në nxitjen e histerisë rusofobike në Mbretërinë e Bashkuar", u tha në deklaratën e Ministrisë së Jashtme të Rusisë. Në listën e 287 personave të

sanksionuar janë përfshirë edhe ish-ministra, por edhe disa persona që nuk janë më deputetë. Ndërkaq, emri i ish-ligjvënësit Dominic Grieve është shkruar dy herë në këtë listë. "Të gjithë këta 287 persona duhet t'i konsiderojnë këto sanksione si nder", tha kryeministri britanik Boris Johnson gjatë një fjalimi në Parlamentin britanik. Më herët, Rusia ia ka ndaluar hyrjen në shtet Johnsonit, së bashku me disa ministra të kabinetit të tij.

## Aktakuzë për krime lufte ndaj ish-liderit boshnjak Ejup Ganiq

Sarajevë, 27 prill - Autoritetet në Sarajevë kanë ngritur aktakuzë për krime lufte ndaj disa ish-politikanëve boshnjakë dhe liderëve ushtarakë për rolin e tyre në vrasjen e ushtarëve jugosllavë në fillim të luftës së Bosnjës në vitet '90. Prokurorët në Sarajevë kanë ngritur aktakuzë ndaj dhjetë personave për përfshirje në sulmin e vitit 1992, kur një konvoj i forcave të Ushtrisë Popullore Jugosllave po tërhiqej

nga Sarajeva, dhe ishte i shoqëruar nga paqeruajtësit e Kombeve të Bashkuara. Në mesin e të dyshuarve janë edhe Ejup Ganiq, ish-anëtari boshnjak i Presidencës së Bosnjës gjatë luftës, dy ish-ministra të Brendshëm dhe disa gjeneralë në pension të ushtrisë boshnjake. Tetë ushtarë të Ushtrisë Jugosllave, punëtorë civilë dhe anëtarë të stafit mjekësor ushtarakë, u vranë dhe 24 të tjerë



u plagosën në këtë sulm, thuhet në aktakuzë. Sulmi i 3 majit të vitit 1992 në rrugën Dobrovolacka ndodhi një ditë pas granatimeve të shumta

në qendër të Sarajevës, granatime që u kryen nga Ushtria Jugosllave dhe forcat serbe të Bosnjës. Ky sulm ndodhi dy muaj pasi Bosnja, përmes një referendumi, votoi për pavarësi nga Jugosllavia. Ganiq dhe të akuzuarit e tjerë dyshohet se kanë "planifikuar, sulmuar dhe kanë nxitur të tjerët që të sulmojnë konvojin e pambrojtur... që ishte i shoqëruar nga forcat

paqeruajtëse të OKB-së" dhe, po ashtu, kanë dështuar që t'i parandalojnë vrasjet dhe t'i dënojnë keqbërësit, thanë prokurorët. Më 2012 prokurorët kishin pezulluar një hetim ndaj Ganiqit dhe 13 ish-liderëve boshnjakë të luftës, që dyshoheshin për krime lufte. Lufta në Bosnjë ka lënë të vdekur pothuajse 100 000 persona dhe mbi 11 500 janë vrarë gjatë rrethimit të Sarajevës.

## Rasti i parë në Kinë i gripit të shpendëve H3N8

PEKIN, 27 PRILL - Kina ka raportuar rastin e parë të gripit të shpendëve H3N8 te njerëzit, por autoritetet shëndetësore thonë se rreziku i transmetimit nga njeriu te njeriu është i ulët. Lloji H3N8 dihet se infekton kuajt, qentë dhe fokat, por nuk ishte zbuluar te njerëzit. Ministria kineze e Shëndetësisë deklaroi se një djalë katërvjeçar, i cili jeton në provincën

qendrore të Henanit, ishte pozitiv me llojin H3N8. Ai u shtrua në spital në fillim të prillit me ethe dhe simptoma të tjera të gripit. Familja e djalit të infektuar rrit pula dhe jeton në një zonë të banuar nga rosat e egra. Siç është thënë, djali ishte infektuar drejtpërdrejt nga shpezët. Ministria e Shëndetësisë shton

se rreziku i infeksionit në shkallë të gjerë është relativisht i vogël. Megjithatë, autoritetet apelojnë që njerëzit të mos u afrohen zogjve të ngordhur apo të sëmurë dhe ta vizitojnë mjekun në rast të temperaturës apo simptomave në frymëmarrje. Rastet e transmetimit të gripit të shpendëve te njerëzit janë jashtëzakonisht të rralla.





“Ndërmarrje e Përbashkët Kriminale” apo luftë çlirimtare e Kosovës? (5)

# Parimet që kanë udhëhequr serbët në procesin e pushtimit dhe të tjetërsimit të trojeve shqiptare



**Shkruan: Kudusi LAMA**

Ndërsa në qoftë se Prokuroria Speciale ka dëshirë të dijë se cilat kanë qenë parimet serbe të ngritura në ligj, përpunuar me plane e programe shtetërore, po i rendisim në vijim. Parimet që kanë udhëhequr serbët në procesin e pushtimit dhe të tjetërsimit të trojeve shqiptare, janë:

1. Të vriten shqiptarët ndonëse paqësorë; të burgosen e të diskriminohet inteligjencia, shkencëtarët, mësuesit, arsimi, gjuha e kultura shqiptare;
2. Të pastrohen trojet shqiptare të pushtuara nga trashëgimia e hershme ilire, për të zhdukur lashtësinë e banimit të këtyre trojeve nga shqiptarët;
3. Sa më tepër shqiptarë të zhduken apo të shpërngulen me forcë, aq më të mëdha janë meritat e çdo serbi para atdheut;
4. Të shfarosen krerët më të rrezikshëm shqiptarë nëpërmjet një plani të studiuar mirë. Kjo të arrihet nëpërmjet nxitjes së vazhdueshme të grindjeve, të gjakmarrjes ose vrasjes së krerëve të njohur duke paguar persona të ndryshëm;
5. Në plan të parë të pushtimit, sundimit dhe shfarosjes për pastrimin etnik të trojeve shqiptare të jetë brigandazhi. Bandat serbo-malazeze të bëhen tmerr i banorëve, t'i shfarosin dhe t'i shpërngulin ata;
6. Persekutimi i shqiptarëve të jetë i shfrenuar. Përveç persekutimit, shtypjes dhe shfarosjes masive, të bëhet edhe përgatitja e opinionit serb nëpërmjet denigrimit të figurës shqiptare në tërësi dhe të çdo shqiptari, në veçanti;
7. Të bëhen të gjitha përgatitjet dhe të arrihet që trevat e forta dhe kompakte të shqiptarëve të shkatërrohen sa më shpejt, duke futur në mesin e tyre të paktën 50 për qind të popullsisë serbo-sllave;
8. Të organizohet e të kryhet “çarmatimi” i popullsisë shqiptare duke armatosur njëkohësisht popullsinë serbe;
9. Çdo shqiptar duhet të pagëzohet në fenë ortodokse, duke bërë përpjekje që brenda disa brezave të serbizohet gjithë populli. Që brenda një kohe të shkurtër asnjë shqiptar të mos

guxojë të flasë gjuhën shqipe;

10. Shqiptarët në trojet e tyre duhet të jenë robër. Ata duhet që kur kolonët sllavë të vendosen në djerrina, të bëjnë kthimin e tyre në toka të punueshme. Të detyrohen të japin kontribut ose të punojnë angari për ndërtimin e shtëpive të kolonëve, bile, edhe t'i strehojnë në banesat e tyre. Kolonët kanë të drejtë t'ua marrin tokën shqiptarëve bashkë me të mbjellat ende të pakorrura, duke bashkërenduar dhunën e tyre me autoritetet. Ata kanë të drejtë t'ua heqin familjeve shqiptare çdo mjet dhe mundësi jetese;
11. Të bashkohen me Serbinë krahina si Shkodra dhe një copë e Shqipërisë së Veriut;
12. Duke pushtuar Kosovën dhe duke tentuar shtrirjen e mëtejshme, po vëmë në vend të drejtat tona historike që kemi pasur me 1389;
13. Të nacionalizohen plotësisht nga serbët krahinat përreth maleve të Sharrit. Kjo do të thotë që të groposen përgjithnjë të drejtat e shqiptarëve për të sunduar trojet e tyre dhe të sigurohet përgjithnjë pushteti serb në këto toka;
14. Me shqiptarët për shfarosjen e tyre duhet vepruar në dy plane: me kolonizimin gradual dhe me forcën brutale

të pushtetit shtetëror. Pra, ngushtimi gradual i shqiptarëve me anë të kolonizimit, kombinuar me shpërnguljen masive;

15. Analfabetizmi të jetë një nga fushat e mbajtjes së shqiptarëve nën sundim. Vetëm ai shqiptar që nuk ka arsim, është i padëmshëm, pasi ai nuk ka mundësi të njohë trashëgiminë historike dhe kulturore të kombit shqiptar. Prandaj, të kemi sa më shumë shqiptarë analfabetë;
16. E drejta e lirisë, demokracisë, dinjitetit dhe kulturës, është vetëm e serbëve. Shqiptarët duhet t'i kenë ato të kufizuara;
17. Serbët këndojnë: “Edhe në ethet e vdekjes, derisa zemra të punojë, do të kërkojmë, që edhe në atë botë këta njerëz të mos jenë fqinjët tanë”;
18. Asgjë nuk duhet të ndodhë apo zhvillohet jashtë interesave serbe, qoftë edhe ngjarjet e rëndësishme historike, duhet të jenë ashtu siç duan serbët, jo ashtu siç kanë qenë apo ndodhur me të vërtetë në kohën e tyre;
19. Të bëhemi predikues të lirisë, të demokracisë dhe të së vërtetës, duke luajtur rolin e një prokurori publik kundër një populli, siç është populli shqiptar nën sundimin serb;
20. Të vihen e vilen taksa për

çdo lindjeje fëmijësh shqiptarë;

21. Ndërtimet urbane në Kosovë dhe viset e tjera shqiptare të bëhen vetëm sipas trashëgimisë urbane të Serbisë, vulat dhe firmat të jenë vetëm serbisht, është e pakuptueshme që ato të jenë shqip. Emrat e vendeve duhet të ndërrohen për të humbur njëherë e mirë çdo shenjë e prejardhjes së këtij kombi;
22. Emërtimi i kombeve dhe popujve të bëhet vetëm serbisht. Po kështu, duhet të zhduken njëherë e mirë emrat kombëtar shqiptar të njerëzve. Ata duhet të emërtohen vetëm me emra serbë;
23. Emigrimi duhet të mbetet një nga rrugët më me efektivitet për shpopullimin e viseve shqiptare;
24. Kisha serbe duhet të propagandojë “gjenocidin” e shqiptarëve kundër serbëve. Shqiptarët të quhen nazistë;
25. Kosovarët të zhvishen nga identiteti i tyre, nga shtëpitë e tyre, nga emërtimet, kujtimet dhe arkivat e tyre. Edhe të gjithëshqiptarët mund të zhduken në emër të Serbisë së Madhe;
26. Të shfrytëzohet kohën për të pastruar dhe serbizuar sa më shumë territore shqiptare, për sa kohë Evropa do ta injorojë çështjen e Kosovës dhe të shqiptarëve në tërësi, ose më

saktë, për sa kohë shqiptarët nuk do të kenë fuqinë t'i diktojnë Evropës që ta kthejë fytyrën nga ata;

27. Të shfrytëzohet fanatizmi etnik e fetar i popullit serb për të nxitur agresivitetin e tyre kundër shqiptarëve;
28. Shkatërrimet, barbaritë, plaçkitjet, djegiet, rrënimet e çdo gjëje që është shqiptare, bombardimet, terrori intensiv, masakrat masive, përdhunimet, zhdukjet e personave, burgosjet masive, përdorimet e të gjitha llojeve të armëve të rënda nga ushtria dhe policia, të mbeten norma të veprimtarisë së përhershme serbe në Kosovë e viset e tjera të populluara me shqiptarë;
29. Vullneti politik i popullit të Kosovës të likuidohet me të gjitha mënyrat e mjetet deri në zhdukjen fizike të tij;
30. Vendet evropiane kanë investuar në Serbi kapital ekonomik dhe politik: Italia mbi 800 milionë dollarë; Franca mbi 1 miliardë dollarë; Gjermania mbi 700 milionë dollarë, ndërsa Rusia ka tregun e armëve të Serbisë. Të shfrytëzohet ky fakt për të bërë që këto shtete të jenë në anën tonë, pasi ndryshimet u sjellin atyre humbje të kapitalit ekonomik dhe rënie të prestigjit politik.

Ja, pra, mbi cilat parime mbështetej veprimtaria serbo-sllave në Kosovë dhe në trojet shqiptare. A mund të kishte bashkëjetesë në këto kushte? A mund të ekzistojë bashkëjetesa? Si e sa mund t'i justifikojë Prokuroria Speciale këto parime naziste? Apo, meqenëse edhe vetë po ushtron një veprimtari naziste, nuk i bën përshtypje të përballet me parimet naziste të ngritura në ligj për asgjësimin e kombit shqiptar në trojet e pushtuara shqiptare nën Jugosllavi, për interesat e Serbisë. A është kjo prokurori speciale në shërbim të Serbisë?

Kjo lojë vazhdon të bëhet edhe sot e kësaj dite me serbët. Ata ushqehen me shpirtin e shfarosjes shqiptare në Kosovë. Ata ushqehen me shpirtin e çlirimit të shenjtë të serbëve në Kosovë. Ata ushqehen me shpirtin e ndjekjes së heronjve serbë në Kosovë, që nuk janë tjetër veçse banditë, vrasës dhe kriminelë. Por, tashmë dihet se historia serbe në Kosovë është historia e pushtimit, e shfarosjes së shqiptarëve autokton, e kolonizimit të pa asnjë rezultat sllav, si dhe historia e Luftës së Kosovës dhe shqiptarëve për çlirim nga kolonizimi. (Vijon)



*Lufta në Kosovë la pas vetes një numër të madh krimesh duke filluar nga vrasjet e torturat prej më të tmerrshme, shumica prej të cilave nuk u zbardhën asnjëherë. Imazhet e këtyre krimeve bënë që bota të njohë një ndër gjenocidet më të mëdha të kryer mbi shqiptarët. E pa dyshim se këtu rol të madh kanë luajtur mediat botërore të cilat kapën pamjet makabre të krimeve të kryera mbi shqiptarët nga ana e forcave serbe.*





FLET PËR "EPOKËN E RE", FERAT SHALA

# Qeveria Kurti, pa strategji zhvillimore

- PDK-ja ka pasur dhe ka indikacione se qeveria Kurti ka qenë dhe është thellë e zhytur në afëra të dyshimta në tërë sektorin energjetik

Deputeti i PDK-së, Ferat Shala, e ka akuzuar qeverinë Kurti për mosrealizimin e premtimeve. Shala ka thënë se kjo qeveri nuk ka asnjë strategji për zhvillimin e vendit. Në këtë intervistë dhënë për "Epokën e re", Shala ka thënë se PDK-ja ka pasur dhe ka indikacione se qeveria Kurti ka qenë dhe është thellë e zhytur në afëra të dyshimta në tërë sektorin energjetik. "Qeveria ka qenë thellë e zhytur në keqmenaxhimin e krizës energjetike, me ndërhyrje politike në gjithë sektorin energjetik, me ndërhyrje në ZRrE, me ndërhyrje të mëdha financiare, pa qartësi dhe transparencë, pa bazë ligjore dhe pa arsye ekonomike", ka thënë Shala. Në këtë kontekst, Shala ka thënë se është e domosdoshme që të themelohet Komisioni Hetimor për Energji. Ndërsa sa i përket opozitës, Shala ka thënë se nuk ka kopjuar asgjë nga metodat opozitare nga e kaluara

**Lirim GECI**

**PRISHTINË, 27 PRILL** - Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Ferat Shala, ka thënë se qeveria e drejtuar nga Albin Kurti është e zhytur thellë në krizën energjetike në vend. Në këtë intervistë dhënë për "Epokën e re", Shala ka thënë se PDK-ja ka pasur dhe ka indikacione se qeveria është e përfshirë në afëra të dyshimta në tërë sektorin energjetik. "Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe grupi parlamentar ka pasur dhe ka indikacione që qeveria Kurti ka qenë dhe është thellë e zhytur në afëra të dyshimta në tërë sektorin energjetik, në eksport, në import, në tenderë njëburimor, në

punësime, në subvencionim të sektorit, me ndërmarrjet publike dhe private të sektorit energjetik, me negociata për zgjidhje të problemit energjetik në pjesën veriore me KOSTT-in, me ZRrE-në, KEDS-in, KESCO-n dhe KEK-un. Problem është heshtja e kryeministrit dhe kabinetit qeveritar. Problem është paaftësia menaxhuese e kësaj qeverie", ka thënë Shala. Për shkak të këtyre dyshimeve, Shala ka thënë se është e domosdoshme që të krijohet Komisioni Hetimor për Energji. "Qeveria ka qenë thellë e zhytur në keqmenaxhimin e krizës energjetike, me ndërhyrje politike në gjithë sektorin energjetik, me ndërhyrje në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë (ZRrE), me ndërhyrje

të mëdha financiare, pa qartësi dhe transparencë, pa bazë ligjore dhe pa arsye ekonomike. Pra, shpenzim i buxhetit me pasoja dhe dyshime të mëdha", ka thënë ai. Shala, i cili është edhe kryetar i Komisionit për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, ka thënë se pa u zbardhur e vërteta e subvencionimit të mbi 100 milionë eurove për energjinë elektrike, nuk mund të ketë asnjë hap zhvillimor. "Presim që opinioni dhe qytetarët ta dinë të vërtetën mbi konsumin vendor dhe importet. Presim të zbardhet e vërteta mbi sektorët energjetikë. Presim që të qartësohet rruga për menaxhim më të mirë të këtij sektori për të ardhmen. Nuk mund të vazhdojmë më tutje në

asnjë hap tjetër zhvillimor pa u qartësuar periudha e dyshuar", është shprehur Shala.

Në këtë intervistë Shala ka folur edhe për opozitën dhe menaxhimin e ndërmarrjeve publike nga ana e pushtetit. Sa i përket opozitës, Shala ka thënë se nuk ka kopjuar asgjë nga metodat opozitare nga e kaluara. Ndërsa për ndërmarrjet publike, Shala ka thënë se janë në një situatë të vështirë. "Asnjë projekt, asnjë strategji, asnjë projekt zhvillimor deri më tani nuk e kemi. Borxhet e këtyre ndërmarrjeve për çdo ditë shtohen me miliona euro. Keqmenaxhimi dhe nepotizmi është i dukshëm. Joprofesionalizmi menaxhues është shumë i lartë", ka deklaruar Shala.

**"Epoka e re": Z. Shala, çfarë vlerësimi keni për punën e qeverisë Kurti?**

**Shala:** Më shumë se një vit kjo qeveri, përjashto skemat sociale, nuk ka arritur që asnjë nga projektet e planifikuara apo të premtuara t'i realizojë. E vetmja gjë për të cilën do të mbahet mend kjo qeveri është shpenzimi i parasë së buxhetit pa asnjë planifikim dhe pa asnjë investim.

**"Epoka e re": Po për punën e opozitës, çfarë vlerësimi keni?**

**Shala:** Opozita ka ndjekur rrugën e qetësisë opozitare, një kulturë që qytetarëve të vendit u duhet. Opozita nuk ka kopjuar asgjë nga mënyrat opozitare të së kaluarës. I ka dhënë hapësirë të mjaftueshme qeverisë për realizimin e synimeve programore të saj e që, fatkeqësisht qeveria, nuk e ka shfrytëzuar këtë mundësi. Por, opozita është edhe në kërkim të metodave dhe praktikave më të mira të të bërit opozitë. Përkundër kësaj qetësie, lë shumë për të dëshiruar që të jetë një opozitë e zëshme, e arsyeshme, e bashkuar, me kauza të qarta ekonomike dhe nacionale. Deri më tani kemi parë vetëm kauzën energjetike dhe asgjë tjetër. Mbesim me shpresë që ditët në vijim opozita të reflektojë dhe të orientohet drejt kauzave shtetërore.

**"Epoka e re": Gjatë këtyre muajve Kosova, përpos rritjes së çmimit të energjisë, është ballafaquar edhe me ngritjen e çmimeve të produkteve elementare. Sipas jush, si e ka menaxhuar qeveria këtë situatë?**

**Shala:** Qeveria "de fakto" dhe "de



# Kosova përkujton të pagjeturit dhe masakrën e Mejës

Përfaqësues të institucioneve të Kosovës, të pozitës dhe të opozitës, kanë përkujtuar të mërkurën 1 600 të zhdukur me dhunë dhe masakrën e Mejës. Ata kanë theksuar se synimi i regjimit gjenocidal serb ishte spastrimi etnik

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 27 PRILL - Me rastin e Ditës së të Pagjeturve, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, bashkë me zëvendëskryeministren, njëherësh ministre e Punëve të Jashtme, Donika Gërvalla, kryetarin e Komisionit Qeveritar për të Zhdukurit, Andin Hoti, deputetë të Kuvendit, ministra të qeverisë dhe familjarë të të zhdukurve me dhunë, ka bërë homazhe të mërkurën pranë obeliskut të të zhdukurve me dhunë, i vendosur para ndërtesës së Kuvendit të Kosovës.

Konjufca ka marrë pjesë edhe në shënimin e 23-vjetorit të masakrës në Mejë të Gjakovës, në nderim të 376 shqiptarëve të vrarë e të masakruar nga forcat pushtuese serbe, në luftën e

fundit në Kosovë.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, në Ditën Kombëtare të të Pagjeturve, e cila përkon me datën e masakrës së Mejës, ka theksuar se kjo ditë është përkujtim, pritje e ankth për familjarët dhe shtetin e Kosovës. "Janë mbi 1 600 të zhdukur me dhunë. Thirrja jonë për drejtësi, e cila do të vihet në vend kur para saj do të dalin autorët e krimeve dhe do të zbardhet fati i secilit nga njerëzit tanë. Duam dhe do të insistojmë të dimë për fatin e tyre. Kjo ditë na bën ta kthejmë kokën pas jo vetëm për t'i kujtuar ata që nuk janë në mesin tonë, por edhe për ta thënë fuqishëm se për ta nuk është vetëm një ditë si kjo, por çdo ditë. Me kujtimin për ta, do të bëjmë çdo ditë përpjekje që pritja e familjeve të marrë fund", ka theksuar presidentja Osmani. Sipas saj,



forcat e regjimit gjenocidal kanë kryer edhe shumë krime të tjera monstruoze në Kosovë, e ndër më të tmerrshmet është masakra e Mejës, në të cilën u vranë barbarisht 376 djem e burra shqiptarë. "Synimi i regjimit gjenocidal serb ishte spastrimi etnik ndaj aksioni kriminal u shtri në 15 fshatra të Rekës së Keqe dhe Luginës së Çarragojës në Gjakovë. Meja është dhimbje e madhe e Kosovës dhe ndër rrëfimet më të përgjakshme të luftës. Nuk do ta harrojmë kurrë, sepse vetëm kësaj do ta dimë vlerën e lirisë dhe shtetit. Do t'i kujtojmë përherë martirët e Mejës duke u angazhuar vazhdimisht që autorët të vihen para drejtësisë", ka theksuar presidentja Osmani në përkujtimin e masakrës së Mejës. Në përvjetorin e masakrës së Mejës, në Ditën e të Zhdukurve me Dhunë në Kosovë, kryeministri Albin Kurti ka thënë se si qeveri janë plotësisht të vetëdijshëm se rikthimi i të pagjeturve të mbetur do të jetë akt gjithnjë e më i vështirë. Ai ka

thënë se kjo çështje ka marrë prioritet në kuadrin e marrëdhënieve dhe bisedimeve me Serbinë. "Sipas të dhënave që disponojmë në bazë të një pune për më shumë se dy dekada, na mungojnë ende 1 617 persona. Pra, mungojnë ende 1 617 prej njerëzve tanë, të familjeve e të vendit tonë. Komisioni ynë dhe organizatat po punojnë. Andaj raportet dhe marrëveshjet tona kanë dhe duhet të vijojnë të kenë në prioritet temën e të zhdukurve me dhunë. I pagjeturi vendos në shoqërinë tonë dhe në familjarët e tij nga një anë dhimbjen dhe, nga ana tjetër, shpresën. Do të bëjmë gjithë ç'mundemi për ta kthyer shpresën në besim e në realitet", ka deklaruar Kurti. Ai ka përkujtuar edhe masakrën e Mejës. "Ata u rrethuan që të shfaroseshin, si shqiptarë që ishin në tokën e tyre ku jetonin. Duke e nxjerrë në dritë krimin ndaj popullit tonë, ne mund ta shtyjmë ndërjegjen ndërkombëtare ta kërkojë pastrimin e ndërjegjes dhe trupit të shteteve agresorë dhe

gjenocidalë. Trupi i territorit të Serbisë ishte dhe ende është përplot me trupa të pagjetë të njerëzve tanë, të rrëmbyer e të vrarë, të vrarë e të rrëmbyer", është shprehur Kurti.

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, i shoqëruar nga bashkëpartiakë, ka bërë homazhe te monumenti i personave të pagjetur në Prishtinë dhe te Kompleksi Memorial në Mejë të Gjakovës. Krasniqi ka thënë se Kosova kërkon drejtësi për 1 617 të pagjeturit e saj, për të cilët edhe sot, 23 vjet pas luftës, nuk dihet asgjë për fatin e tyre.

Ndërkaq për masakrën e Mejës, Krasniqi ka thënë se kjo masakër shpërfaqë barbarinë e regjimit serb, qëllimi i të cilit ishte spastrimi etnik i shqiptarëve.

Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se Dita e të Pagjeturve shënohet pikërisht në ditën e masakrës në Mejë e Korenicë ku brenda ditës u martirizuan qindra vëllezër e motra tona, vetëm pse ishin shqiptarë.



juro" ka qenë jashtë lojës me menaxhimin e situatës së inflacionit. Asnjë nga mekanizmat e saj institucionalë nuk ka qenë funksional dhe në krye të detyrës, me masa preventive në mbajtjen nën kontroll të inflacionit. Ndërsa qeveria ka qenë thellë e zhytur në keqmenaxhimin e krizës energjetike, me ndërhyrje politike në gjithë sektorin energjetik, me ndërhyrje në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë (ZrRE), me ndërhyrje të mëdha financiare, pa qartësi dhe transparencë, pa bazë ligjore dhe pa arsye ekonomike. Pra, shpenzim i buxhetit me pasoja dhe dyshime të mëdha.

**"Epoka e re":** PDK-ja është duke insistuar në themelimin e Komisionit Hetimor për Energjinë, derisa pozita është duke e kundërshtuar një gjë të tillë. Pse duhet të themelohet ky komision?

**Shala:** Komisioni Hetimor duhet të themelohet që ta zbardhë të

vërtetën e menaxhimit të keq qeveritar në tërë periudhën e krizës energjetike. Pra ta zbardhë arsyeshmërinë e subvencionimit të mbi 100 milionë eurove, ta zbardhë arsyeshmërinë e importeve energjetike, ta zbardhë arsyeshmërinë e eksporteve, ta zbardhë arsyeshmërinë e çmimeve. Po ashtu, ky komision duhet të themelohet për t'i zbardhur të dhënat reale mbi prodhimin vendor, t'i zbardhë partnerët vendorë e ndërkombëtarë që kanë punuar me Kosovën gjatë periudhës së krizës energjetike dhe t'i zbardhë kontratat njëburimore si dhe shumë defekte të tjera në këtë sektor.

**"Epoka e re":** Mediet sllovene para disa ditësh raportuan për përfshirjen e ambasadorit të Kosovës në Kroaci në afëra korruptive, që e ndërlihdin atë me mafinë energjetike serbe. A ka



pasur indikacione PDK-ja për diçka të tillë, pasi më herët insistonte të themelohet Komisioni Hetimor?

**Shala:** Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe grupi parlamentar kanë pasur dhe kanë indikacione që qeveria Kurti ka qenë dhe është thellë e zhytur në afëra të dyshimta në tërë sektorin energjetik, në eksport, në import, në tenderë njëburimor, në punësime, në subvencionim të sektorit, me ndërmarrjet publike dhe private të sektorit energjetik, me negociata për zgjidhje të problemit energjetik në pjesën

veriore me KOSTT-in, me ZRrE-në, KEDS-in, KESCO-n dhe KEK-un. Problem është heshtja e kryeministrit dhe kabinetit qeveritar. Problem është paafësia menaxhuese e kësaj qeverie.

**"Epoka e re":** Personalisht, çfarë prisni të dalë në pah nga hetimi parlamentar për energjinë?

**Shala:** Presim që të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet në pikat e lartcekura të zbardhen. Presim që opinioni dhe qytetarët ta dinë të vërtetën mbi konsumin vendor dhe importet. Presim të zbardhet e vërteta mbi sektorët energjetikë. Presim që të qartësohet rruga për menaxhim më të mirë të këtij sektori për të ardhmen. Nuk mund të vazhdojmë më tutje në asnjë hap tjetër zhvillimor pa u qartësuar periudha e dyshuar.

**"Epoka e re":** Z. Shala, ju jeni edhe kryetar i Komisionit për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti.

Mund të na thoni se si janë duke operuar ndërmarrjet publike që nga ardhja në pushtet e qeverisë Kurti?

**Shala:** Mbështetur në raportet e performancës, ndërmarrjet publike janë në një situatë jashtëzakonisht të rëndë, me theks të veçantë Trepça, KOSTT-i, Posta, KEK-u, ndërmarrjet e ujësjellësve regjionalë. Gjithashtu, në gjendje të rëndë janë Trainkos-i dhe Infrakos-i. Të vetmet ide qeveritare deri më tani janë pretendimet që t'i futin nën një kulm administrativ, të quajtur fondi sovran, e që për ne është pothuajse e pamundur dhe utopike, sidomos në situatën që ndodhen këto ndërmarrje. Asnjë projekt, asnjë strategji, asnjë projekt zhvillimor deri më tani nuk e kemi. Borxhet e këtyre ndërmarrjeve për çdo ditë shtohen me miliona euro. Keqmenaxhimi dhe nepotizmi është i dukshëm. Joprofessionalizmi menaxhues është shumë i lartë.



## Zvicra dhuron pajisje biometrike për policinë kufitare

PRISHTINË, 27 PRILL (ER) - Policia e Kosovës ka pranuar një donacion nga Ambasada e Zvicrës, pajisje biometrike për policinë kufitare. Pranim-dorëzimi i këtij donacioni u nënshkrua nga drejtor i Departamentit për Kufi, Ragip Bunjaku, si dhe Eva Kitzler,

shefe e ICPMD-së për Ballkan. Ky donacion dëshmon bashkëpunimin e vazhdueshëm të Policisë së Kosovës dhe partnerëve siç është Ambasada e Zvicrës e cila me këtë donacion të pajisjeve të specializuara po ndihmon në avancimin dhe

ngritjen profesionale të kapaciteteve të Policisë së Kosovës. Pajisjet do të shërbejnë për parandalimin dhe identifikimin e migrimit të parregullt si dhe personave të tjerë të dyshimtë e që ndikon edhe në sigurinë e përgjithshme.



## Komunat kërkojnë transparencë nga qeveria dhe koordinim të plotë

PRISHTINË, 27 PRILL (ER) - Organizuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) është mbajtur takimi i Këshillit të Kryetarëve për të diskutuar lidhur me grantet qeveritare 2023 për komunat e Kosovës dhe për unifikimin e qëndrimit të komunave për komisionin e granteve të Qeverisë së Kosovës. Ky takim është organizuar në vigjilje të takimit të Komisionit të Granteve. Komunitet e Kosovës përfaqësohen në këtë komision me katër kryetarë: Përparim Rama (Prishtinë), Alban Hyseni (Gjilan), Sokol Haliti (Viti) dhe Dragan Petković (Partesh).

Kryesuesi i këtij takimi, Sokol Haliti, anëtar i bordit të AKK-së, pasi ka paraqitur rendin e ditës, ka arsyetuar këtë takim, duke thënë se komunat duhet të koordinohen para takimit të Komisionit të Granteve, me theks te financimi komunal në periudhën 2023-2025. Kryetari Haliti në vazhdim



para nivelit qendror. Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, duke qenë edhe anëtar i Komisionit të Granteve, tha se ende nuk kanë materiale për këtë takim, por janë këtu që ta marrin mendimin e gjitha komunave. Kryetari i Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka thënë se si komuna janë të papërgatitur për këtë takim pasi, sipas tij, nuk mund të

shkohet në një takim pa asnjë material pune për mbledhje. Kryetari i komunës së Kaçanikut, Besim Ilazi, ka thënë se për këtë moskoordinim të mirëfilltë mes komunave dhe qeverisë në fund do të pësojnë qytetarët tanë. Ai ka thënë se, përveç problemeve të tjera kryesore, është çështja e Kontratës Kolektive e cila po dëmton në masë të madhe

komunat që, sipas tij, u nënshkrua nga ministra të caktuar pa asnjë bashkëpunim me komunat. Kryetari i komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, ka thënë se në takim duhet të shkohet për t'i paraqitur brengat e komunave. Kryetari i komunës së Mamushës, Abdulhadi Krasniq, ka theksuar se në Komisionin e Granteve dhe te

financimi komunal në periudhën e ardhshme duhet të kihen parasysh edhe komunat e vogla sipas formulave të deritashme. Në këtë takim kanë debatuar edhe kryetarët e tjerë të komunave dhe ata në fund u pajtuan që komunat të jenë unike në qëndrimin e tyre sepse kjo është në interes të pushtetit lokal në Kosovë dhe të qytetarëve të tyre.



## UP-ja dhe komuna e Prishtinës, marrëveshje bashkëpunimi

PRISHTINË, 17 PRILL (ER) - Rektori i Universitetit të Prishtinës, Naser Sahiti dhe kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, kanë institucionalizuar bashkëpunimin nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjes, e cila ka për qëllim hartimin, aplikimin dhe zbatimin e projekteve, elaboreve dhe studimeve të përbashkëta,

organizimin dhe realizimin e forumeve profesionale në fushat relevante për palët, realizimin e këshillimeve profesionale reciproke, ofrimin e mundësive për realizimin e praktikës profesionale për studentët, harmonizimin e përmbajtjeve mësimore me nevojat e tregut të punës si dhe funksionalizimin e institucioneve

të përbashkëta profesionale dhe shkencore. Rama ka thënë se komuna e Prishtinës është tejet e përkushtuar për thellimin e bashkëpunimit me Universitetin e Prishtinës, por edhe me institucionet e tjera edukativo-arsimore për të shtyrë përpara projekte me interes të përbashkët për kryeqytetin.

## Mbingarkohet Klinika Emergjente, 871 raste për katër ditë

Prishtinë, 27 prill (ER) - Klinika Emergjente e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës vazhdon të mbetet e mbingarkuar me pacientë

që po marrin trajtim emergjent mjekësor. Bazuar në raportin e punës të kësaj klinike, për katër ditë në këtë klinikë ndihmë mjekësore emergjente kanë

marrë 871 pacientë me sëmundje të ndryshme. Prej tyre, 96 pacientë janë pranuar për trajtim të mëtejshëm në klinikat kirurgjike, internistike dhe

Mjekim Intensiv Qendror. Po ashtu, janë kryer 15 operacione emergjente, 54 raste pas aksidenteve në trafik, shtatë raste të helmimeve.





# Me moton 'Mbrojeni botën tuaj, vaksinohuni!' shënohet Java Evropiane e Imunizimit

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 27 PRILL - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës ka shënuar Javën Evropiane të Imunizimit. Shënimi i kësaj jave ka për qëllim ngritjen e vetëdijes te politikëbërësit, punëtorët shëndetësorë, prindërit dhe kujdestarët, po ashtu edhe tek e gjithë popullsia për rëndësinë e imunizimit, për t'i mbrojtur fëmijët nga sëmundjet e parandalueshme përmes vaksinimit dhe duke theksuar rolin kyç të profesionistëve shëndetësorë në ndërtimin e praktikave të parandalimit ndaj sëmundjeve ngjyese vaksinë-preventabile. Drejtori i IKShPK-së, Naser Ramadani, ka thënë se në Kosovë Programi i Zgjeruar i Imunizimit është program me prioritet të lartë dhe se të gjitha programet e miratuara dhe ndryshimet në vetë Programin e Zgjeruar të Imunizimit, duke përfshirë edhe kalendarin e vaksinimit, bëhen në përputhshmëri me rekomandimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe në vijë me politikën e imunizimit të

miratuar nga Ministria e Shëndetësisë.

Ai ka thënë se ngritja e shkallës së imunizimit të fëmijëve në 95 për qind, që është një përfshirje e lartë, e radhitë Kosovën në mesin e vendeve më të suksesshme në botë sa i përket programit të vaksinimit të fëmijëve. "Falë vaksinimit, Kosova sot nuk ka paraliza të fëmijëve e as difteri nga viti 1981, tetanus neonatal nga viti 1998, si dhe ka përfaqëuar Programin e Eliminimit të Fruthit dhe Kontrollit të Rubellës Kongjenitale", ka thënë ai. Zëvendësministria e Shëndetësisë, Dafina Gexha, ka thënë se pandemia Covid-19 është shembulli më unik për të treguar se sa i ekspozuar është sot njerëzimi para rreziqeve shëndetësore por, në të njëjtën kohë, ajo tha se është shembulli më i mirë për të dëshmuar se solidariteti midis njerëzve nuk duhet të njohë kufij dhe duhet t'i kontribuojë mbrojtjes së solidaritetit.

Përfaqësuesja e zyrës së UNICEF-it në Kosovë, Dafina Muçaj, ka theksuar se që nga fillimi i pandemisë UNICEF-i në Kosovë ka



bashkëpunuar me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike në mënyrë që ta minimizojnë impaktin e Covid-19 në imunizimin e rregullt. "UNICEF-i së bashku me organizatat me bazë në komunitet ka përkrahur identifikimin derë më derë të fëmijëve të cilët nuk janë vaksinuar në mënyrë që Institucionet e Kujdesit Parësor Shëndetësor të vazhdojnë vaksinimin plotësues të këtyre fëmijëve", ka thënë ajo.

Përfaqësuesja e Zyrës së OBSH-së në Kosovë, Edita Haxhiu, ka thënë se objektivat e fushatës së këtij viti janë: të rritin ndërgjegjësimin e publikut për mbrojtjen e ofruar nga vaksinat kundër sëmundjeve dhe vdekjeve gjatë gjithë jetës; të krijojnë mbështetje në mesin e profesionistëve të kujdesit shëndetësor për vaksinimin gjatë gjithë jetës; t'i angazhojnë politikëbërësit shëndetësorë dhe menaxherët e programeve të vaksinimit për miratimin e një

qasjeje gjatë jetës ndaj vaksinimit. Gjithashtu, ajo u shpreh se në muajt dhe vitet në vijim programet e imunizimit në rajon do të duhet të mbajnë mbulim të lartë vaksinimi në çdo nivel administrativ. Kjo nënkupton sigurimin e marrjes së lartë të shërbimeve të rregullta të imunizimit, lehtësimin e imunizimit të ri për fëmijët dhe të rriturit që kanë humbur dozat në të kaluarën dhe integrimin në këto shërbime të të gjithë të ardhurve, përfshirë migrantët dhe refugjatët.

## Skandali i ambasadorit Berishaj, PSD-ja aksion për 'pastrimin e parave' para qeverisë



PRISHTINË, 27 PRILL (ER) - Partia Socialdemokrate (PSD) ka zhvilluar të mërkurën një aksion para ndërtesës së qeverisë, me çrast ka dërguar tri lavatriqe të mbushura me para, që simbolizojnë pastrimin e parave.

Zyrtari i kësaj partie, Zgjim Hyseni, ka thënë se po bëhet një javë nga skandali korruptiv i ambasadorit të Kosovës në Kroaci. "Secilën ditë mësojmë nga një fakt shtesë. Të gjithë flasin, të gjithë pyesin, institucionet heshtin. Berishaj ka hapur kompani në Mal të Zi me veten e tij punëtor, dhe hopa 600 mijë euro tërheqje. Paratë në dorë, të gjitha në strajcë. Prejardhja Beogradi. Atje nuk bëhet dot shitblerje energjie pa rënë në rrjetin monopol të kompanive që kontrollojnë gjithë tregun energjetik: EFT dhe Rudknap. Këto kompani lidhen me emrat Hamoviç, Fazliq e Stanishiç. Afera na drejton kah mafia ballkanike e energjisë", ka thënë ai. Hyseni ka thënë se Martin Berishaj paska bërë edhe evazion fiskal në

Mal të Zi. "Raportet tregojnë se xhirologaritë e tij në Mal të Zi janë ngrirë. Mësojmë pastaj se super Martin Berishaj i paska katër nënshitetësi: kosovare, shqiptare, slovene dhe malazeze. Mësojmë se super Martini është edhe profesor, edhe ambasador, paramendo edhe sekser i rrymës. Morëm vesh që profesori sekser i paska fshehur kompanitë nga AKK. Vetëm kaq mjafton për t'u thirrur në përgjegjësi sepse kjo në Kosovë është vepër penale. Dje u bë e ditur se bashkë me profesorin e filozofisë të specializuar për tregti të rrymës, në Slloveni për këtë qëllim paskan qenë edhe udhëheqësit e KEK-ut. Kjo na tregon se afera është institucionale, se këtu ka piramidë. Mos harroni, Nagip Krasniqi është kryeshf i KEK-ut i caktuar nga qeveria Kurti", ka thënë Hyseni, duke shtuar se secili moment që kalon me Martin Berishajn në detyrë, "kemi të drejtë të besojmë se këtu kemi të bëjmë me piramidë institucionale dhe shpëlarje parash".

## 13 raste të reja me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 27 PRILL (ER) - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se pas 822 testeve, 13 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes.

Të mërkurën janë shënuar 23

qytetarë, ndërsa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 224 454. Në total numri i rasteve aktive është 412.

Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit janë dhënë 250 doza të vaksinës kundër Covid-19.

Prej fillimit të vaksinimit në të

gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 825 708 doza të vaksinës. Deri më sot 821 889 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë.

Deri më sot janë dhënë 101 327 doza përforcuese dhe doza të treta të vaksinës kundër Covid-19.





# PDK-ja: Të zbardhet e vërteta e shitblerjes së rrymës



**EPOKA  
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 27 PRILL** - Zyrarët e Partisë Demokratike të Kosovës në një konferencë për medie ka kërkuar që sot (e enjte) në seancën e Kuvendit të Kosovës, Komisioni Hetimor për Krizën Energjetike të përkrahet dhe të votohet nga deputetët e Vetëvendosjes.

Deputetja e PDK-së, Blerta Deliu-Kodra, ka thënë se të enjten në seancën e Kuvendit të Kosovës në rend dite është Komisioni Hetimor për ta zbardhur keqmenaxhimin që ka ndodhur me rastin e krizës energjetike në vend, dhe bllokada që i është bërë këtij komisioni nga partia në

pushtet vetëm sa e dëshmon se diçka po fshihet në këtë proces. “Në kohën kur çmimi i energjisë elektrike është rritur për 100 për qind, natyrisht ka pasur rritje që ka afektuar qytetarët e Republikës së Kosovës dhe, në të njëjtën kohë, shihet se qeveria ka subvencionuar me 125 milionë euro energjinë elektrike në kohë të krizës, ndërkohë që ne kemi ngritur dilemat tona sepse nuk kemi asnjë informatë se ku kanë shkuar mjetet e subvencionuara të energjisë elektrike”, ka thënë ajo.

Po ashtu, Deliu ka thënë se mediumi publik RTK nuk ka transmetuar në edicionin e tij qendror të lajmeve konferencën

jashtëzakonshme të PDK-së, të mbajtur dje, ku kryetari i GP të PDK-së, Abelard Tahiri dhe deputeti Ferat Shala kanë paraqitur fakte se gjatë muajve shkurt, mars dhe prill, Kosova më shumë ka eksportuar sesa ka importuar energji elektrike. “Ne nuk kemi parë asnjë transmetim të konferencës së djeshme ku u prezantuan me fakte, me argumente, me statistika se si është keqmenaxhuar në kohën e krizës me çmimet e energjisë elektrike dhe si janë dëmtuar qytetarët e Republikës së Kosovës”, ka thënë ajo. Në anën tjetër, anëtar i kryesisë së PDK-së, Bernard Nikaj, ka thënë se Komisioni Hetimor, i propozuar nga opozita, duhet të aprovohet

në seancën e nesërme pa asnjë vonesë, sepse vonesat shkojnë në dëm të xhepit të qytetarëve të Kosovës. “Është shumë e rëndësishme që çështja e Komisionit Hetimor, e iniciuar nga opozita dhe çështja e Komisionit Hetimor e iniciuar sot nga GP i Lëvizjes Vetëvendosje, janë dy çështje të ndara. Aq sa është e rëndësishme që të hetohet e kaluara, edhe më e rëndësishme është të hetohet menaxhimi i krizës energjetike, koston e të cilit po e mbajnë qytetarët e Kosovës në faturat e tyre të rrymës”, ka deklaruar ai. Nikaj ka theksuar se skandali Ballkanik energjetik në të cilin është i përfshirë ambasadori i Kosovës në Kroaci e shton

rëndësinë e themelimit të këtij komisioni. “Rëndësinë e themelimit sa më parë të Komisionit Hetimor e shton edhe skandali ballkanik energjetik në të cilin është i përfshirë ambasadori i Kosovës në Kroaci. Mediet sllovene aludojnë se është bërë shpërlaje parash dhe tregti me energjinë. Kjo është bazë e mjaftueshme dhe dëshmi shtesë pse komisioni duhet të themelohet. Hezitimi i partisë në pushtet për ta themeluar këtë komision, aq më keq për ta penguar, vetëm sa i shton dyshimet edhe më shumë. Prandaj, themelimi urgjent i këtij komisioni që të zbardhet e tërë e vërteta është e domosdoshme”, ka thënë Nikaj.

## 26 mijë familje në skemën sociale marrin dyfishin e vlerës

**PRISHTINË, 27 PRILL (ER)** - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka njoftuar të mërkurën se në kuadër të

pakos mbështetëse rreth 26 mijë familje në skemën sociale do ta marrin dyfishin e vlerës. “Me datën 15 prill shtesa prej 100 eurosh u është shpërndarë

rreth 280 mijë pensionmarrësve. Ndërsa sot, në kuadër të pakos mbështetëse, rreth 26 mijë familje në skemën e ndihmës

sociale do ta marrin dyfishin e vlerës tashmë të rritur. Çdoherë në mbështetje të qytetarëve”, ka shkruar Murati në llogarinë e vet në “Facebook”.





# Analogjia Ukrainë-Tajvan: Frika reale dhe krahasimi i rremë



Nga Farid KAHHAT

Disa ditë pas fillimit të pushtimit rus të Ukrainës, fluturimi i disa avionëve luftarakë kinezë pranë ishullit të Tajvanit provokoi shqetësim në mbarë botën. Por ky shqetësim ishte në fakt i panevojshme pasi “zona e identifikimit të mbrojtjes ajrore” të Tajvanit, ku fluturuan avionët kinezë, është më e gjerë sesa hapësira e saj ajrore.

Po ashtu, fluturime të tilla nuk kanë qenë të pazakonta, pasi kanë ndodhur mbi 900 herë që nga krijimi i zonës ajrore. Ndërkohë, çdo krahasim midis rasteve të Tajvanit dhe atyre të Ukrainës anashkalon faktin se përtej kontekstit aktual, Tajvani është në fakt më i rëndësishëm për Shtetet e Bashkuara sesa Ukraina.

Për shembull, ndërsa Tajvani

është partneri i 9-të tregtar i SHBA-së, Ukraina është e 67-ta në këtë listë. Kompania kryesore e prodhimit të gjysmëpërçuesve në botë ndodhet pikërisht në Tajvan, dhe produktet e saj luajnë një rol vendimtar në zinxhirët e furnizimit ndërkombëtar.

Sa i përket sigurisë, Tajvani është i pari nga 2 vargjet e ishujve në të cilët Shtetet e Bashkuara do të bënin çdo përpjekje për të frenuar zgjerimin detar të Kinës. Por nëse Ukraina do t'i bashkohej ndonjëherë aleancës ushtarake të NATO-s, ajo do të ishte vetëm një nga pesë anëtarët e NATO-s që ndajnë një kufi me Rusinë (Polonia dhe Lituania kufizohen gjithashtu me enklavën e Kaliningradit).

Nga ana tjetër, kufijtë e Letonisë dhe Estonisë janë më afër Moskës sesa kufiri Rusi-Ukrainë.

Kur Shtetet e Bashkuara vendosën të vendosin lidhjet diplomatike me

Kinën komuniste, ajo përdori atë që e quajti “politikë të paqartësisë strategjike” përkundrejt Tajvanit (ose siç quhej ndryshe Republika e Kinës).

Paqartësia qëndronte në faktin se ndërsa e pranonin Tajvanin si pjesë të një shteti të vetëm kinez, Shtetet e Bashkuara nuk patën asnjë qasje specifike për çështjen e sovranitetit të tij. Për sa i përket sigurisë, kjo paqartësi përfshihet në Aktin e Marrëdhënieve me Tajvanin të vitit 1979, i cili angazhon Shtetet e Bashkuara të ndihmojnë Tajvanin në kapacitetet e tij mbrojtëse, pa i detyruar në mënyrë eksplicite Shtetet e Bashkuara që të ndërhyjnë ushtarakisht për të mbrojtur ishullin.

Ky akt përcakton se çdo përpjekje për të përcaktuar të ardhmen e Tajvanit me mjete jopaqësore, do të përbënte një shqetësim të madh

për Shtetet e Bashkuara. Shtetet e Bashkuara kanë një angazhim zyrtar për sigurinë e Tajvanit, i cili është më shumë sesa mund të jetë ai për Ukrainën.

Sigurisht që nuk ka asgjë të paqartë në zgjedhjen e kësaj qasjeje. Nga njëra anë, ai akt synonte ta bindte Tajvanin që të mos vepronte në mënyrë provokative ndaj Kinës, i përforcuar nga garancitë e sigurisë nga Shtetet e Bashkuara.

Nga ana tjetër, ndërkohë synohej siguria që kinezët të mbeten të shqetësuar ndaj pasojave të testimit të kësaj paqartësie, siç ndodhi gjatë krizave në Ngushticat e Tajvanit në vitet 1950 (kur Kina i kishte nënvlerësuar gjasat e ndërhyrjes së SHBA-së).

Por edhe në politikën e “paqartësisë strategjike”, Shtetet e Bashkuara kanë një angazhim zyrtar për sigurinë e Tajvanit, që është shumë më e fortë sesa ajo që

mund të thuhet për Ukrainën. Sjellja e NATO-s ndaj kësaj të fundit, është një shembull i asaj që ekonomistët e quajnë “stimuli pervers”.

Nga njëra anë, në samitin e Bukureshtit të prillit 2008, aleanca i premtoi Gjeorgjisë dhe Ukrainës se do t'i bashkoheshin NATO-s, gjë që nxitte shqetësimet e Moskës për sigurinë kombëtare (dhe këto shqetësime janë reale, edhe nëse disi të tepuara).

Nga ana tjetër, 14 vjet pas këtij zotimit, NATO nuk ka filluar as të përpunojë kandidaturat e tyre dhe as t'u japë garanci sigurie për këtë periudhë tranzicioni. Prandaj nuk është çudi që ndërhyrjet ushtarake të Rusisë në Gjeorgji dhe Ukrainë, ndodhën pas Samiit të Bukureshtit. Me krizën Rusi-Ukrainë po dalin shumë leksione sesi Perëndimi duhet ta shohë Kinën. / “Worldcrunch” – Bota.al





**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT  
PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJOËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Prishtina fiton derbin ndaj Gjilanit

Prishtina ka shfrytëzuar krizën e Gjilanit dhe ka rrëmbyer tri pikë të plota, shumë të rëndësishme në garën për mbijetesë. Po ashtu, fitore të rëndësishme për mbetjen në elitë ka shënuar edhe skuadra e Dukagjinit, e cila e ka deklasuar Feronikelin. Pas dy humbjeve, fitores i është rikthyer edhe Drenica që e ka fituar përballjen me Ulpianën



Feronikeli është në vendin e fundit dhe në edicionin e ri do të bëjë gara në Ligën e Parë. Pas tri ndeshjeve radhazi pa fitore, dy humbjeve dhe një barazim, skuadra e Drenicës është rikthyer te fitorja në Superligën e Kosovës. Kuqezinjët kanë shënuar fitore me rezultat 3-1. Golashënues për vendasit ishin Osman Mëziu (13') dhe Armend Abazi (53', 63'). Për mysafirët realizues ishte Elvis Ahmet (89'). Drenica pas kësaj fitore ka 39 pikë dhe renditet e shtata, kurse Ulpiana është e nënta me 24 pikë.

### Sot zhvillohen dy ndeshje të tjera

Sot (e enjte) zhvillohen dy ndeshje të tjera në Superligën e Kosovës në futboll për xhiron e 31-të. Të dyja ndeshjet pritet të jenë shumë interesante. Ballkani, që është lider në elitë, e pret skuadrën e Dritës. Nëse vendasit shënojnë fitore në këtë ndeshje, atëherë titulli do të jetë edhe më afër, por gjilanasit do të përpiqen ta mposhtin skuadrën e Ballkanit dhe të ndalojnë

**BKT SUPERLIGA**

Gjilani - Prishtina	1-2
Drenica - Ulpiana	3-1
Dukagjini - Feronikeli	4-0

Të enjten takohen:  
16:00 Ballkani - Drita  
16:00 Malisheva - Llapi

**TABELA**

1. Ballkani	30	66 pikë
2. Drita	30	55
3. Gjilani	31	55
4. Llapi	30	50
5. Prishtina	31	42
6. Drenica	31	39
7. Malisheva	30	37
8. Dukagjini	31	36
9. Ulpiana	31	24
10. Feronikeli	30	12

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 27 PRILL** - Skuadra e Prishtinës ka arritur ta fitojë derbin ndaj Gjilanit (1-2) në kuadër të javës së 31-të në Superligën e Kosovës në futboll. Në minutën e 33-të Albert Dabiqaj ka shënuar për epërsinë e parë të vendasve, por mysafirët e kanë barazuar rezultatin në fund të pjesës së parë. Shënues nga penalltia ishte Besnik Krasniqi. Në minutën e 80 Mankenda realizoi golin e fitores për skuadrën kryeqytetase. Prishtina me tri pikët e reja

ngrehet në vendin e pestë me 42 pikë, kurse Gjilani mbetet në vendin e tretë me 55 pikë. Fitore në kuadër të javës së 30 kanë shënuar edhe Dukagjini dhe Drenica, duke mposhtur Feronikelin, përkatësisht Ulpianën. Dukagjini e ka deklasuar Feronikelin duke e mposhtur me rezultat 4-0. Vendasit kanë shënuar tri gola në pjesën e parë të ndeshjes. Shënues ishin Altin Merlaku, Arbër Shala dhe Ergyn Ahmeti. Në pjesën e dytë Dukagjini realizoi edhe golin e katërt nëpërmjet Stefan Nikoliqit. Pas kësaj ndeshje, Dukagjini ka grumbulluar 36 pikë dhe zë vendin e tetë.

sadopak në garën për titull. Në ndeshjen tjetër, Malisheva e pret Llapin. Vendasit luftojnë për tri pikë, pasi synojnë të qëndrojnë në Superligë, ndërsa Llapi kërkon fitore për t'u ngritur sa më lart në renditjen tabelore.

## Prishtina e Re mundi Rahovecin në ndeshjen e parë të 'play-out'-it

**PRISHTINË, 27 PRILL** - Prishtina e Re ka shënuar fitore ndaj Rahovecit me rezultat 93:89 (20:25, 23:24, 27:22, 23:18) në ndeshjen e parë të "play-out"-it. Mysafirët e nisën ndeshjen më mirë, duke pasur epërsi deri në 11 pikë në çerekun e parë, 10:21, por me kalimin e minutave vendasit ngushtuan

epërsinë, ku kjo pjesë përfundoi me rezultat 20:25. Periudha e dytë u karakterizua si e barabartë, ku "Vreshtarët" ngrehnin epërsinë dhe vendasit afronin, duke e bërë sfidën shumë interesante, ndërsa pjesa e parë përfundoi 43:49. Edhe perioda e tretë ishte interesante,

ku prishtinasit nuk u dorëzuan dhe ngushtuan shifrat maksimalisht në 70:71, sa ishte rezultati në semafor pas 30 minutash. Rahovecasit sërish kishin epërsi deri në tetë pikë në dhjetë minutat e fundit, por kryeqytetasit nuk dorëzohen dhe dy minuta nga fundi kalojnë në



epërsi për herë të parë 88:87. Kjo bëri që fundi të ishte interesant, ndërsa përfundoi me fitoren e Prishtinës së Re, 93:89. Ndeshja e dytë zhvillohet të shtunën në Rahovec dhe skuadra që është më e mirë nga të dy ndeshjet do të garojë në elitën e basketbollit në edicionin e ardhshëm.

## Presidenti i KOK-ut pret boksierët pas suksesit në Kampionatin Evropian



**PRISHTINË, 27 PRILL** - Presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës ka pritur të mërkurën delegacionin e boksit pas suksesit të arritur në Kampionatin Evropian të Rinjve (U-18), të mbajtur në Sofië të Bullgarisë, me ç'rast boksierët Taulant Jakupi dhe Donat Sylja, fituan medaljet e bronzta. Të pranishëm në takim

ishin edhe kryetari i Federatës së Boksit të Kosovës (FBoxK), Enver Krasniqi, trajneri Faton Xhakli, dhe gjyqtari Latif Demolli, i cili ndau drejtësinë në Evropian. Presidenti Krasniqi përgëzoi boksierët për suksesin e arritur, duke thënë se medaljet e fituara do t'ua hapin rrugën drejt

sukseseve të reja në arenën ndërkombëtare. Në emër të federatës, kryetari Krasniqi falënderoi presidentin e KOK-ut për pritjen, derisa theksoi se si federatë do të punojnë bashkë me trajnerët për të arritur sa më shumë suksese në garat jashtë vendit. Trajneri Xhakli dhe boksierët

folën për luftërat që kishin në Evropian, ndërsa shprehën optimizëm për rezultate të reja. Jakupi fitoi medaljen në një konkurrencë prej 11 boksierëve në kategorinë 86 kg, ndërsa Sylja në konkurrencë prej 12 boksierëve në kategorinë 92 kilogramë. Të dy shënuan nga një fitore.

## Akademia Olimpikë e Kosovës anëtarësohet në Akademinë Olimpikë të Evropës

HKomiteti Olimpik i Kosovës (KOK) që nga viti 2022 ka qenë anëtar i Akademisë Olimpikë të Evropës, ndërsa anëtarësimi i tij është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Katërt e EOA me datën 21 prill. Drejtori Fitim Arifi së bashku me koordinatoren Diellza Kelmendi ishin dy prezantuesit e aktivitetëve të Akademisë

Olimpikë të Kosovës (AOK). Me rastin e këtij anëtarësimi të AOK-ut në Akademinë Olimpikë të Evropës, kjo e fundit ka reaguar përmes një komunikate zyrtare duke treguar se qëllimi i EOA-s është që t'i krijojë mundësitë që sporti në Kosovë t'i arrijë pikat më të larta botërore. Shkrimin e plotë të EOA-së e

gjeni më poshtë. "Drejtori Fitim Arifi dhe koordinatori Diellza Kelmendi prezantuan aktivitetet e Akademisë. KOA është pjesë e NOC të Kosovës dhe ka detyrën që t'i promovojë vlerat olimpikë në Kosovë. Misioni i Akademisë është që t'i promovojë vlerat olimpikë dhe shpirtin olimpik, po ashtu t'i sjellë standardet më të larta të

edukimit dhe profesionalizmit të komunitetit të sportit në Kosovë. Vizioni i Akademisë Olimpikë është që ta përforcojë brendin olimpik në Kosovë duke ndërgjegjësuar për Lëvizjen Olimpikë dhe edukimin e gjeratave të profesionistëve në fushën e sportit për të krijuar mundësi për sporte më të forta dhe më të



zhvilluara në Kosovë", thuhet në njoftimin e KOK-ut.



## Ancelotti: Rezultati nuk është i mirë, nuk u mbrojtëm mirë

MADRID, 27 PRILL - Trajneri i Real Madridit, Carlo Ancelotti, pas humbjes së gjysmëfinaleve të parë kundër Manchester Cityt, ka thënë se skuadra e tij nuk është mbrojtur mirë në ndeshjen që pësoi humbje me rezultat 4-3.

“Rezultati nuk është i mirë, pasi kemi pësuar katër gola. Nuk mbrojtëm mirë. Kur kishim topin u krijonim probleme, por duhet të mbrohemi më mirë. Ky është një rezultat që mund të ndryshojë në ndeshjen e kthimit.

Manchester City është një ekip shumë i fortë, e tregoi edhe në këtë ndeshje. Gjithsesi ne u përballëm denjësisht. Çelësi për të kaluar në finale është të mbrojmë mirë. Nuk mund të mbulosh një pozicion me katër

mbrojtës. Duhet të vendosësh edhe një mesfushor. Duhet të tregohemi më të vëmendshëm. Kishim mundësi kur zotëronim topin, vuajtëm pak që ta nxirrjmë topin, por duhet të kemi besim në vetvete”, ka thënë Ancelotti.



## Ramos: Dua t'i tregoj PSG-së çfarë jam i aftë të bëj

PARIS, 27 PRILL - Mbrojtësi Sergio Ramos tashmë është duke menduar për sezonin e ardhshëm. Pas një viti të trazuar për të mos thënë më shumë, mbrojtësi spanjoll dëshiron t'i tregojë Paris Saint-Germainit se ai është ende një lojtar i rëndësishëm. Ndërsa ka folur për kanalet zyrtare të klubit të Parisit, ish-kapiteni i Real Madridit theksoi se është përshtatur dhe dëshiron vijimësinë te PSG-ja. “Në fund, luajta pak, nuk ua arrita qëllimeve të mia. Dua t'i tregoj skuadrës çfarë jam i aftë të bëj, nuk ka gëzim më të madh sesa kur të jem në gjendje ta realizoj këtë gjë. Kam kaluar kohë të mrekullueshme këtu. Kaloj mirë me Thilo Kehrerin dhe me Keylor Navasin, që është si vëlla dhe si anëtar familje për mua. Përshtatja ime me të ishte më e lehtë se me pjesën tjetër, për faktin se dikur



kemi qenë miq në kohën kur të dy ishim në Madrid”, ka thënë Ramosi.

36-vjeçari ka kontratë deri në verën e vitit 2023 me PSG-në, por duke ditur se gjatë sezonit që tashmë është drejt fundit mbrojtësi ka

qëndruar më shumë jashtë fushës së blertë për shkak të dëmtimeve, parisienët kanë bërë edhe pa të dhe në asnjë moment mungesa e spanjollit nuk është parë si penalizim për ekipin e Mauricio Pochettinos.

### SHKURT

#### Guardiola: 8-0 do të ishte rezultati më i mirë për ne

Manchester City zhvilloi një ndeshje spektakolare në “Etihad Stadiumin” ndaj Realit, duke fituar 4-3. Trajneri Pep Guardiola u shfaq i kënaqur pas ndeshjes. Strategu i Manchester Cityt nuk e fshehu keqardhjen për rastet e shumta të shpërdoruar nga skuadra e tij por, megjithatë, e përgëzoi skuadrën për performacën e bërë. “Do të donim të fitonim me diferencë më të madhe, por edhe 4 me 3 nuk është një rezultat i keq. Ata janë Realit i Madridit, një skuadër me armë të fuqishme në sulm. Kur një trajner sheh skuadrën e tij të luajë kështu, ka pak për të thënë edhe pse është një gjysmëfinale të Ligës së Kampionëve. Pësuam 3 gola, e vërtetë, por dhamë gjithçka dhe bëmë një ndeshje të bukur. A u kënaqëm? Askush nuk mund të mos kënaqej edhe pse 8-0 do të ishte rezultat më i mirë për ne. Do të luajmë lojën tonë edhe në Madrid”, ka deklaruar Guardiola.

#### PSG-ja e gatshme ta shesë Neymarin

Neymari ka edhe tre vjet kontratë me PSG-në, por francezët janë të gatshëm ta shesin sulmuesin që e kanë bërë për shifrën rekord 222 milionë euro. “Sky Sport” shkruan se klubi francez i ka vendosur edhe çmimin yllit të sulmit. PSG-ja pranon të futet në bisedime për të paktën 90 milionë euro. Kampionët e Ligës 1 po mendojnë për largimin e disa lojtarëve në verë, me synim ndërtimin e një ekipi që ta garantojë fitimin e Ligës së Kampionëve që është kthyer në një fiksim.

#### Interi i ofron kontratë të re Inzaghit

Interi po bën një sezon të mirë. “Zikaltrit” kanë fituar Superkupën e Italisë dhe janë në finalen e Kupës. Kampionët e Italisë janë në garë për mbrojtjen e “Scudetos”, 4 javë nga fundi. Një nga më të merituarit për këtë edicion ka qenë edhe trajneri Simone Inzaghi. Sipas “Corriere dello Sport”, klubi po mendon që të rinovojë me teknikun, teksa marrëveshjes aktuale që skadon në vitin 2023 i shtohen edhe dy vjet të tjera. Gjithashtu, po merret parasysh edhe përmirësimi i kushteve ekonomike. 46-vjeçari fiton 4 milionë euro në sezon, ndërsa paga e re parashikon shifrën e 5.5 milionë eurove. Inzaghi në stolin e Interit numëron 46 sfida. Ekipi, nën drejtimin e tij, ka marrë një mesatare prej 2.13 pikësh.

#### Lewandowski ka vendosur të largohet nga Bayerni

Sulmuesi Robert Lewandowski ka vendosur ta vijojë karrierën në një skuadër tjetër në verë. Sipas gazetës gjermane “Bild”, menaxheri i futbollistit, Pini Zahavi, do të takohet në orët e ardhshme me drejtuesit e klubit “bavarez”, siç ishte planifikuar tashmë, për të diskutuar për të ardhmen e polakut. Synimi është largimi i sulmuesit këtë verë, edhe pse ka edhe një vit kontratë me kampionët e Bundesligës. Mirëpo kupola drejtuese e Bayernit nuk dëshiron ta lëshojë golashënuesin më të mirë të Bundesligës. Gjithsesi lojtari dëshiron me çdo kusht të nisë një aventurë të re futbolli, pasi mendon se e ka mbyllur ciklin të “bavarezët”. Përveç kësaj, “Bild” shkruan se Lewa nuk ka marrëdhënie të mira as me bordin, as me trajnerin.

## Miami kualifikohet në gjysmëfinale

MIAMI, 27 PRILL - Pas Bostonit edhe ekipi i Miamit siguron një biletë për në gjysmëfinale “play-off” në Konferencën e Lindjes, skuadra nga Florida mundi 97-94 Atlantën, duke fituar 4-1 serinë e çerekfinaleve. Ndeshje me rivalitet deri në fund, ku për Miamin u dalluan Oladipo me 23 pikë e Adebayo me 20 pikë e 11 rebounde. Hunteri realizoi 35 pikë e 11 rebounde për Atlantën, por që mbetën për statistikë. Në Perëndim skuadra e Phoenixit udhëheq 3-2 serinë e ndeshjeve, duke fituar me rezultat 112-97 ndaj



New Orleansit. Sfidë e komanduar nga Suns, ku u dallua Brides me 31 pikë, mbështetur nga Pauli me 22 pikë e Aytoni me 19. Fitore të vështirë korri Memphis, që

mposhti 111-109 Minnesotan dhe udhëheq 3-2 serinë e çerekfinaleve. Morant me 30 pikë e 13 rebounde si dhe Bane me 25 pikë i dhanë fitoren Memphis.

#### KONFERENCA E LINDJES - ÇEREKFINALE “PLAY-OFF”

Miami - Atlanta	97-94	(4-1)
Philadelphia - Toronto	(3-2)	
Milwaukee - Chicago	(3-1)	
Boston - Brooklyn	(4-0)	

#### KONFERENCA E PERËNDIMIT - ÇEREKFINALE “PLAY-OFF”

Phoenix - New Orleans	112-97	(3-2)
Dallas - Utah Jazz	(3-2)	
Golden State - Denver	(3-1)	
Memphis - Minnesota	111-109	(3-2)

## Venezia shkarkon trajnerin

Klubi i Venezias ka shkarkuar trajnerin Paolo Zanetti. Sipas asaj që raporton gazetari i njohur dhe eksperti i merkatos, Gianluca di Marzio, klubi lagunar ka

shkarkuar nga detyra e trajnerit teknikun që e ngjiti një kategori më lart, atë të Serisë A. Venezia ka vendosur për këtë arsye t'i japë një shkundje ekipit

duke zgjedhur ndryshimin e stolit vetëm 5 ndeshje nga përfundimi i këtij edicioni futbollistik. Ky lajm i është komunikuar ekipit dhe pritet vetëm njoftimi zyrtar i

klubit. Venezia aktualisht mban pozicionin e fundit në renditje me 22 pikë, -6 nga vendi i 17 që mbijeton në Serinë A. Venezia nuk fiton prej 9 ndeshjesh, ku ka

koleksionuar 8 humbje, 1 barazim dhe 0 fitore. Suksesi i fundit daton më 12 shkurt në transfertë ndaj Torinos me përmbysje me rezultat 1-2.





**Retender  
Terms of Reference**

**For Purchase of Supply Electric Equipment**

**Project Name:** Support the Employment of Youth in Energy Sector  
**Project Number:** 2020/419-482  
**Service Provision for:** Purchase of Supply Electric Equipment  
**Length of Contract:** 1 Months  
 5 May 2022 – 5 June 2022  
**Location / Place of Performance:** Kosovo

**BACKGROUND  
Terms of Reference  
Support to Employment of Youth in Energy  
Sector  
Purchase of Home Automation and Video-  
Citophony Electrical Panels, and cabinet  
necessary practical equipment**

**Project Name:** Support to Employment of Youth in Energy Sector  
**Project Number:** 2020/419-482  
**Provision of:** Electrical Panels  
**Length of Contract:** 1 month  
 5 May - 5 June, 2022  
**Type of Contract:** Framework Contract  
**Description:** Purchase of Home Automation and Video-Citophony Electrical Panels as per ANNEX 2 specifications, and additional necessary equipment for cabinets, including transportation at beneficiaries' premises  
**Location / Place of Performance:** Kosovo

**BACKGROUND:**

The overall goal of the project is to *increase employability, sustainable employment prospects for disadvantaged groups, namely youth and women in the energy sector in Kosovo.* "Support to Employment of Youth in Energy Sector" is funded by European Commission and implementing by BSCK. The Project directly contributes to this priority through training between 200 – 400 youths, which will benefit from capacity development within the project, and indirectly thousands of other youth, will benefit from improved curricula of public VET institutions. The Project is a direct investment to improving the quality of vocational training for energy sector professions, and directly support investments in vocational training, competence centers, aiming in creating job opportunities for youth and women and disadvantage groups.

**PURPOSE OF ASSIGNMENT:**

The purpose of this assignment is the provision of Home Automation and Video-Citophony Electrical Panels for professional public schools in the Prishtina Region Municipalities based on the school needs. This assignment will contribute directly to project activity A.2.1. Piloting of new curricula by certified trainers in three electrical modules, and help students grasp the concepts of home automation and video-citophony.

The objective of this assignment is to purchase the tools/equipment and distribute them to public professional schools with the purpose of:

- Building technical/professional skills among targeted marginalized youth
- Support transition from school to work for targeted youth in electrical installations professions
- Promote employment and self-employment in the new professions in the energy sector

The Business Support Center Kosovo (BSCK) is inviting interested bidders to bid for the procurement of:

Artikulli	Pershkrimi anglisht	Pershkrimi shqip	Sasia
	Dimmer light actuator + Command 3 module L4652 / 3	Aktuator drite dimer + Komandë 3 module L4652/3	10
	Dimmable light bulb	Llampe( poq) i dimerueshem	10
	BUS cable	Kablo BUS	25metra
	SCS THERMAL ACTIVATOR 4 RELAYS	Aktuator temperature	10
	LL TEMP.SENSOR W SCREEN 2M	Termostat temperature	10
	Dana 1000V	Dana 1000V	50
	Screwdrivers minus and plus	Kaqavida minus dhe plus	100
	Undressing perches	Dana zhveshese per perques	25
	Fuse 1P 10A	Sigurese 1P 10A	50
	Fuse 1P 16A	Sigurese 1P 16A	50
	Fuse 1P 32A	Sigurese 1P 32A	15
	FID 40A 4P	FID 40A 4P	10
	Unipolar circuit breaker	Nderpreres njepolar	50
	Alternate switches	Nderpreres alternativ	40
	Crossover switch	Nderpreres kryqezor	40
	Serial interrupt	Nderpreres serik	50
	Deep fi60 box	Kutia fi60 e thelle	250
	Single-phase spin	Spina njefazore	25
	Threc-phase spinc	Spina trefazore	10
	Distribution table with 3 rows	Tabele shperndarese me 3 rreshta	5

Technical Specification / Home Automation and Video-Citophony Electrical Panel additional equipment.

**NOTE: The supplier should include the cost of distribution of equipment and tools in schools located in Prishtina region**

Attached you will find Annex.2 with the required specification for each item. Bidders are required to fill the empty columns in Annex.2!

**PLACE OF ASSIGNMENT:**

Distribution shall be throughout Prishtina Region Municipalities, at beneficiaries' premises, accompanied with BSCK Project Team.

**SCHEDULES**

The assignment should be fulfilled in the second week of August. During this period the provider must deliver the Electrical Panels throughout Prishtina Region Municipalities at beneficiaries' locations.

**LANGUAGE:**

All communication between the providers (Company) is to be done in English.

**APPLICATION PROCEDURE**

Bids are to be sent electronically to: [info@bsckosovo.org](mailto:info@bsckosovo.org)

Subject of the email: Bid for Home Automation and Video-Citophony Electrical Panels, Project no.: 2020/419-482 Company Name

The bid shall consist in PDF format files, as follows:

- Business Certificate
- Certificate of VAT;
- Company Details/Profile;
- Financial Offer as per products' specifications in ANNEX 1, and including transportation costs at beneficiaries' premises. Prices shall be without VAT

**APPLICATION DEADLINE: 04 May, 2022 at 15:00**





### FTESË PËR APLIKIM

#### Grante për vetëpunësim

**Emri i projektit dhe referencat: 2020 / 419-482 MBËSHTEJJA E PUNËSIMIT TË TË RINJËVE NË SEKTORIN E ENERGIJISË, Aktiviteti A.6**

Projekt "Mbështetja e Punësimit të Rinjëve në Sektorin e Energjisë" është projekt i financuar nga zyra e Bashkimit Evropian në Prishtinë, i implementuar nga Business Support Center Kosovo në partneritet me Komunën e Fushë Kosovës nën kontratën e grantit 2020 / 419 482 të nënshkruar më 27.10. 2020, ka qëllimin e përgjithshëm për të rritur punësimin dhe perspektivat e qëndrueshme të punësimit për grupet në disavantazh, përkatësisht të rinjtë dhe gratë në sektorin e energjisë në Kosovë.

Në kuadër të projektit "Mbështetja e Punësimit të Rinjëve në Sektorin e Energjisë", aktiviteti A.6, ka për qëllim t'i mbështesë startup idea apo/dhe biznese të reja individuale. Me këtë rast, BSCK fton të gjithë personat të cilët plotësojnë kriteret e vendosura në udhëzimet dhe kushtet për aplikim, të aplikojnë për grante për vetëpunësim.

**Mënyra e aplikimit është online ku përfshihet plotësimi i formularit të regjistrimit Aneksin 1 dhe Aneksin 2 dhe bashkëngjitja e dokumenteve të listuara më poshtë në formatin pdf (të skenuara):**

- Letërnjoftimi i aplikantit fizik apo përfaqësuesit ligjor për aplikime nga biznese;
- Biografia e aplikuesit fizik apo Certifikata e regjistrimit të biznesit (për biznese të regjistruara);
- Koncepti i Plan Biznesit
- Certifikata trajnimit dhe dokumente shtesë që i konsideroni se mund t'i japin vlerë të shtuar aplikimit tuaj

Përparësi për të përfutur nga ky projekt do të kenë: gratë, të rinjtë e papunë, minoritetet, personat apo biznese të reja të cilët kanë ndjekur trajnimin në tre module elektrike, të organizuar nga BSCK.

Afati i fundit për aplikim: **15.05.2022**

Ju lutem klikoni në linkun në vijim për të mbushur aplikacionin:

Për të shkarkuar format e aplikimit dhe për më shumë informacione vizitoni uebfaqen <https://bsckosovo.org/>.



1



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E PRISHTINËS-OPŠTINA PRISHTINA MUNICIPALITY OF PRISHTINA

Nr. prot.: 2486

Dt. 27.04.2022

### SHKOLLA E MESME E LARTË

#### "GJIN GAZULLI"

#### FTESË PËR OFERTË

Sipas UA 2/2016 për organizimin e ekskursioneve dhe organizimeve të tjera jashtëkurrikulare dhe me lejen zyrtare për një organizim të tillë nga DKA e Prishtinës të datës 26.04.2022, KDSH dhe drejtori i SH. M. L. "GJIN GAZULLI" në Prishtinë bën ftesë për ofertë për të gjitha kompanitë të interesuara për realizimin e ekskursionit për maturantë me specifikat e më poshtme:

Ekskursion 5 ditor në Shqipëri

Të interesuarit duhet të kenë këto dokumente:

1. Certifikata e biznesit;
2. Certifikata e regjistrimit;
3. Vërtetimi tatimor (me numër fiskal);
4. Kopjen e letërnjoftimit (ID);
5. Kopje e kartelës së bankës (Xhirologjaria bankare);
6. Leja e punës si dhe referenca
7. Certifikata mjekësore për vozitësit
8. Kontrolla teknike e autobusëve

Vërejtje: Ofertat duhet të jenë në zarf të mbyllur dhe të dorëzohen në afat prej 7 (shtatë) ditësh në DKA nga dita e publikimit në faqen e shkollës në Facebook dhe në njërin nga gazetatat ditore deri në orën 16:00.

Gjatë hapjes së ofertave, prezentë do të jetë drejtori i shkollës dhe një përfaqësues i KDSH dhe do të vendoset për ofertën më cilësore dhe me të volitshme për mësimdhënës, nxënës dhe prindërit e tyre.

· Çdo paqartësi apo pyetje që keni rreth kësaj çështjeje mund të vini në drejtorinë e shkollës.

· Ofertat të cilat nuk i plotësojnë kriteret e kërkuara nuk do të shqyrtohen fare.

Prishtinë, më: 27.04.2022

Nga drejtorja e shkollës

### NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Blu@Net O.P." SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. Unik Identifikues: 811747916 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

### OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Blu@Net O.P." D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nr. Unik Identifikues 811747916 ujedno imenovao Likvidatora o sprovedjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavlivanja o novine.

### ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "Blu@Net O.P." L.L.C. has come to the decision to quit its business: Unik Identifikues 811747916 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Gjumnazi "Eqrem Çabej" në Prishtinë

### FTESË PËR OFERTË

Nr. prot.: 289  
Dt. 27.04.2022

Sipas UA 2/2016 për organizimin e ekskursioneve dhe organizimeve të tjera jashtëkurrikulare dhe me lejen zyrtare për një organizim të tillë nga DKA e Prishtinës të datës 26.04.2022, KDSH dhe drejtori i Gjumnazit "Eqrem Çabej" në Prishtinë bën ftesë për ofertë për të gjitha kompanitë të interesuara për realizimin e ekskursionit për maturantë me specifikat e më poshtme:

#### 1.Ekskursion 5 ditor në Shqipëri

Të interesuarit duhet të kenë këto dokumente:

1. Certifikata e biznesit;
2. Certifikata e regjistrimit;
3. Vërtetimi tatimor (me numër fiskal);
4. Kopjen e letërnjoftimit (ID);
5. Kopje e kartelës së bankës (Xhirologjaria bankare);
6. Leja e punës si dhe referenca
7. Certifikata mjekësore për vozitësit
8. Kontrolla teknike e autobusëve

Vërejtje: Ofertat duhet të jenë në zarf të mbyllur dhe të dorëzohen në afat prej 7 (shtatë) ditësh në DKA nga dita e publikimit në faqen e shkollës në Facebook dhe në njërin nga gazetatat ditore deri në orën 16:00.

Gjatë hapjes së ofertave, prezentë do të jetë drejtori i shkollës dhe një përfaqësues i KDSH dhe do të vendoset për ofertën më cilësore dhe me të volitshme për mësimdhënës, nxënës dhe prindërit e tyre.

- Çdo paqartësi apo pyetje që keni rreth kësaj çështjeje mund të vini në drejtorinë e shkollës.
- Ofertat të cilat nuk i plotësojnë kriteret e kërkuara nuk do të shqyrtohen fare.

Prishtinë, më 27.04.2022

Nga drejtorja e shkollës



## &gt;&gt; SHPALLJE TË VOGLA &lt;&lt;

► Apollon Haxhidauti nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi".

► Rexhë Morina nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e k. I. Të SH.M. Ekonomike "Kadri Kusarikryer në "Mustafabakia" Gjakovë.

► Dren Dhomi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. III të SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha" dega Elektroteknik.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalin me qira. Lokali është i pasitur me të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

# Lokali me qira

Lëshohet lokali me qira. Lokali ka 75 m2. Lokali gjendet tek "REB BULLI", në Prizren. Për informata mund të na kontaktoni në këta numra të telefonit: **044-514-373 dhe 044-199-707.**

RESTAURANT

SWISS  
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

